



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

“Kujtesa Net” Sh.p.k.
Pronar: “Kujtesa Net” Sh.p.k.
OSHP “K SPORT 3”
Rr. Pashko Vasa Nr. 18
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KKPM-2012/07
Ref: 1211/1092/KPM/ni

VENDIM

lidhur me licencimin e ofruesit të shërbimeve programore “K SPORT 3” - Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për distribuimin kabllor të programeve radiotelevizive në Kosovë (CIMC 2007/04) ka hyrë në fuqi më 06.07.2007. Ndërsa, në bazë të Nenit 16 të Rregullores CIMC 2007/04, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore, të cilët do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtësore dhe të cilat do të transmetohen vetëm përmes operatorëve kabllorë.
3. Më 21 shtator 2012 kandidati, për Ofrues të Shërbimeve Programore “K SPORT 3”, ka paraqitur në KPM aplikacionin për Licencë të KPM-së.

Arsyetim

4. Në bazë të nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore do të rregullohen sikurse subjekte transmetuese.
5. Kandidati për licencë të KPM-së “K SPORT 3”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhëna për Licencë të KPM-së, për të ofruar shërbime programore dhe në pajtueshmëri me Nenin 16 të Rregullës CIMC 2007/04, ofruesi i shërbimeve programore “K SPORT 3” ka paraqitur të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së.
6. Komisioni i Pavarur për Media, vlerëson se kandidati “K SPORT 3” ka ofruar informacione të mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Informacionet e ofruara, mund të konsiderohen si informacione bindëse lidhur me skemën programore në përgjithësi, duke paraqitur një strukturë të qartë organizative, informacione rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve programore.

7. Në pajtim me nenin 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore "K SPORT 3", do të veprojnë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
8. KPM, vlerëson se ofruesi i shërbimeve programore "K SPORT 3" ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

Vendim

9. Komisioni i Pavarur për Media, konkludon se "K SPORT 3" ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve përmes sistemit kabllor.
10. Komisioni i Pavarur për Media, vendosë që ofruesit të shërbimeve programore "K SPORT 3", me seli në Prishtinë, t'i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore në Republikën e Kosovës.
11. Në bazë të Nenit 3.2 të Rregullores për Distributim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca për "K SPORT 3" do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.
12. Në pajtueshmëri me Nenin 5.1, të Rregullores për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës për shërbimet mediave audio-vizuale (KKPM-2010/02), çdo Ofrues i Shërbimeve Programore duhet të paguajë taksë vjetore. Niveli i taksës vjetore për licencë të OSHP-TV është i përcaktuar me Nenin 4.3.1. të rregullores së lartpërmendur në këtë paragrafë.
13. Në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2010/02, përkatësisht me nenin 5.2, të kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimeve programore "K SPORT 3", duhet ta paguajë taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimi të vendimit për licencim.
14. Ofruesi i Shërbimeve Programore "K SPORT 3", mund të fillojë transmetimin e programit vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.

Lëshimi i Vendimit

15. Këtë vendim e lëshon Komisioni.


Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media




18. 11. 2012
datë